



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE G. - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:132418

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06247083

C.nr.484/21

GJYKATA THEMELORE NË G.-DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj në çështjen juridike të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike- Distrikti në G., kundër të paditurit L.I.B. nga fshati S. Komuna e Malishevës, për shkak të kompensimit të dëmit material me vlerë: **360.45 Euro**, jashtë seance, me datën **03.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR Padia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike- Distrikti në G., e ushtruar me datë 23.06.2021, kundër të paditurit L.I.B. nga fshati S. Komuna e Malishevës, për shkak të kompensimit të dëmit material me vlerë: **360.45 Euro**.

A r s y e t i m

Paditësi i lartpërmendur, në këtë gjykatë me datë 23.06.2021, ka parashtruar padinë dhe kërkesëpadinë kundër të paditurit të lartcekur për kompensimin e dëmit material.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë i ka dërguar të paditurit Aktvendimin për përgjigje në padi të datës 01.10.2021, së bashku me padinë dhe provat e padisë, mirëpo deri më tani nuk ka parashtruar përgjigje në padi edhe për kundër se i ka pranuar me datë 19.10.2021 dhe 21.07.2022.

Nga pala Paditëse në këtë gjykatë me datë 30.04.2024 ka ardhur parashtrësia përmes së cilës e tërheqin padinë lidhur me kompensimin e dëmit material në vlerë prej 374.03 pasi që tani padituri e ka përmbushur obligimin në emër të Rikthimit të Humbjeve e cila u vërtetua në bazë të transaksionit të konsumatorit dhe fletëpagesave të prezantuara nga i padituri, andaj bëjmë tërheqjen e padisë dhe nuk kërkojmë Aktvendim te Veçantë. Po ashtu për këtë padi është realizuar edhe pagesa e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20.00.

Duke u bazuar në parashtresën e paditësit dhe meqenëse i padituri deri më tani nuk ka paraqitur përgjigje në padi, Gjykata konform nenit 261 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Procedurës Kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë.
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr. 484/21, datë 03.10.2024

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.
ankesës.